

7 prill 2026,  
Prishtinë

## Vendim i Bordit të FBK-së i datës 07.04.2026, Prishtinë

Miratimi i përkohshëm i anëtarësimit të BC Ferizaj Wolves

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht neni 24, dhe në përputhje me Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim në FBK, me datë 07.04.2026, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 28/2025-26 të Komisionit të Garave, Bordi i FBK-së vendos si në vijim:

- I.** Miratohet përkohësisht regjistrimi i ekipit BC Ferizaj Wolves si anëtar i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në përputhje me Vendimin Nr. 28/2025-26 të Komisionit të Garave.
- II.** Ky miratim është i natyrës së përkohshme dhe vlen deri në vendimmarrjen përfundimtare nga Kuvendi i FBK-së, në mbledhjen e radhës, ku pranimi i anëtarëve të rinj bëhet me më shumë se 50% të votave të delegatëve të pranishëm, në përputhje me Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim në FBK.
- III.** BC Ferizaj Wolves, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, gëzon të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga statusi i anëtarit të përkohshëm të FBK-së, në përputhje me aktet normative në fuqi të FBK-së.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,  
Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

